



FOTO: FATKEQËSITË NATYRORE NUK NJOHIN KUFINJ – KONKURSI I PIKTURES

PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe
Mal i Zi - Kosovë 2014- 2020

Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

Edicioni i nëntë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- »»» Gjashtë projekte të financuara në kuadër të Thirrjes së Dytë për propozime Brenda IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi - Kosovë 2014-2020.....2
- »»» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri3
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë5

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian



MNE – ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



MNE – KOS


IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020



Gjashtë projekte të financuara në kuadër të Thirrjes së Dytë për propozime brenda IPA Programit të bashkëpunimit ndërkuftarë Mal i Zi - Kosovë 2014-2020

Thirrja e Dytë në kuadër të Programit IPA BNK Mali i Zi - Kosovë 2014 - 2020 që bashkoi alokimet vjetore të viteve 2016 dhe 2017 u publikua me 15 janar të vitit 2019 nga Ministria e Financave e Malit të Zi - Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së (CFCU). Thirrja u shpall për prioritetin e parë tematik "Promovimi i punësimit, lëvizshmërisë së punës dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit" dhe për prioritetin e tretë tematik "Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore". Nga 2.040.000,00 euro të fondeve të BE-së që ishin në dispozicion, 2.016.678,23 euro janë kontraktuar. Në total, 16 partnerë të projekteve janë të angazhuar në

Partners per country



zbatimin e projekteve (7 nga Mali i Zi dhe 9 nga Kosova). Për më tepër, e gjithë zona e Programit do të mbulohet dhe trajtohet me projektet e kontraktuara.

Në kuadër të Thirrjes së Dytë do të zbatohen projektet në vijim:

- **Krijimi i punësimit në bujqësi** - zbatuar nga Kryeqyteti Podgorica - Departamenti për Ndërmarrësi dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës - IADK;
- **PRAXIS** - zbatuar nga Caritas Kosova, Caritas Mali i Zi, QAKP Gjon Nikollë Kazazi - Gjakovë dhe Komuna e Beranës;
- **CARES 2 - Veprimet ndërkuftare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues 2** - zbatuar nga FORS Mali i Zi - Fondacioni për

zhvillimin e veriut të Malit të Zi dhe ECMI Kosovë - Qendra Evropiane për Çështjet e Pakicave;

- **Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara** - zbatuar nga Komuna e Andrijevices, Komuna e Deçanit dhe shoqata e Alpinistëve "Shkelzen Haradinaj" nga Deçani;
- **Transhumance – ofertë e re turistike në Kosovë dhe Mal të Zi** - zbatuar nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, Agjencia e Zhvillimit Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije, Komuna e Istogut;
- **Trashëgimia kulturore - Thesari i rajonit ndërkuftar** - zbatuar nga Komuna e Pejës dhe Komuna e Gucisë.

Informacione mbi projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Projekti “Ishujt e Gjelbërt”

Në datë 22 tetor të vitit 2020, në sallën e bashkisë Malësi e Madhe u mbajt një konferencë me rastin e përmbylljes së aktiviteteve të projektit *Ishujt e gjelbërt*. Projekti me kohëzgjatje 30 muaj, u zbatua në zonën e komunes së Beranes (Mal i Zi) dhe bashkisë Malësia e Madhe (Shqipëri), nga një konsorcium përfituesish i përbërë nga komuna Berane dhe Caritas i Malit të Zi në anën e Malit të Zi dhe VIS Albania dhe bashkia Malësia e Madhe nga ana shqiptare.



Qëllimi i projektit ishte mbrotja e mjedisit në zonat synuara, rritja e kapaciteteve të punonjësve nga institucionet publike dhe krijimi i një sistemi eficient dhe të integruar të grumbullimit të mbetjeve.

Në fjalën përshëndetëse, **Lisjana Çukaj**, përfaqësuese e bashkisë Malësi e Madhe, tha që ky projekt ishte shumë eficient dhe që ndërgjegjësimi për ndarjen e mbeturinave po bëhej për herë të parë në bashkinë Malësi e Madhe. Ajo gjithashtu informoi të pranishmit që kontenerët për grumbullimin selektiv të mbetjeve ishin instaluar në 8 ishuj ekologjik (të gjelbërt) dhe 58 kontenerë me kapacitet 1100 litragrupe në të gjithë territorin. Ajo theksoi që bashkia Malësi e Madhe është në përputhshmëri me prioritetet e qeverisë dhe që projekti ka krijuar poashtu edhe mundësi bashkëpunimi me komunitetin dhe shkollat.

Të njëjtat aktivitete dhe prokurime janë zbatuar edhe në Mal të Zi, në komunën e Beranes.

Anna Carboni, përfaqësuese e VIS Albania tha që funksionimi i duhur i sistemit të grumbullimit selektiv të mbetjeve kërkon shumë përkushtim nga ana e komunitetit dhe aktorëve të përfshirë dhe që pas këtij projekti menaxhimi eficient i grumbullimit të mbetjeve në bashkinë Malësia e Madhe është funksional. VIS ka insistuar në bashkëpunimin me institucionet për ndarjen dhe grumbullimin e mbetjeve në bashkinë Malësi e Madhe, duke deklaruar që zhvillimi i turizmit në zonë kërkon angazhimin e qytetarëve në mbrotjen e mjedisit, jo vetëm si kërkesë ndaj institucioneve por edhe ndaj vet familjeve në komunitetet respektive.

Në fjalën e saj, **Sonila Kocli**, koordinatore e projektit *Ishujt e gjelbërt*, prezantoi rezultatet e arritura nga projekti në të dy anët e kufirit. Ajo shpjegoi për të pranishmit që për arsye të pandemisë COVID 19 partnerët nga ana e Malit të Zi nuk paten mundësi të marrin pjesë në konferencën përmbyllëse. Gjithashtu, ajo tha që angazhimi i

komunitetit dhe bashkisë Malësi e Madhe për menaxhimin e mbetjeve dhe ndarjen në burim të mbetjeve duhet të vazhdojë, duke vënë theksin tek edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës nga aspekti i përfitimit nga procesi i riciklimit, i cili sjell jo vetëm ndikim pozitiv mjedisor mbi shëndetin e njerëzve por edhe përfitim ekonomik.

Inxhinieri i mjedisit në sektorin e shërbimeve publike në bashkinë Malësi e Madhe, **Kledis Kukaj**, tha që menaxhimi i mbetjeve është prioritet i




bashkisë dhe që ky është ndër të parët raste kur zbatohet ndarja e mbetjeve në dy kategori (të thata dhe të lagura) nëpërmjet përfshirjes së 1000 familjeve në Malësi të Madhe, me qëllim shtrirjen në të tjera territore, për të ecur gradualisht drejt sistemit me dy kosha, siç parashikohet në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve.

Gjatë takimit u konkludua se nëpërmejt këtij projekti është përmirësuar mbrotja e mjedisit në zonën e synuar dhe që është bërë progres i dukshëm në të dy komunat/bashkitë sa i përket sistemit të integruar të grumbullimit të mbetjeve.

Konkursi i pikturës

Në kuadër të projektit *Fatkeqësitë nuk njohin kufinj* zbatuar nga FORS Montenegro në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Brendshme të Malit të Zi dhe Prefekturën Shkodër nga Shqipëria u organizua një konkurs pikturë me nxënësit e shkollave 9 vjeçare, me temë fatkeqësitë natyrore fokusuar tek përmbytjet.



Para konkursit, u organizuan punëtori të konceptuara specifikisht mbi këtë temë, me qëllim informimin e fëmijëve mbi llojet e fatkeqësive që godasin më shpesh bashkinë e tyre dhe mënyrën si ata dhe familjet e tyre mund të kontribuojnë për zbutjen e pasojave. Nxënësit e 6 shkollave nga komunat e Tivarit, Podgoricës dhe Ulqinit nga ana e Malit të Zi dhe bashkia Shkodër nga Shqipëria, morën pjesë në konkurs.

Komisioni i përbërë nga përfaqësues të grupit të punës së projektit dhe një mësues i lëndës së artit, vendosën të jepnin dy çmime për secilin shtet. Nga ana e Malit të Zi, çmimet i'u dhanë nënësve Sara Halili dhe Emir Kaleziq nga shkolla "Marshall Tito" në Ulqin. Punimet fituese mund të shihen [këtu](#).

Projekti *Fatkeqësitë nuk njohin kufinj* kishte për qëllim të përforconte kapacitetet e institucioneve dhe shërbimeve në Mal të Zi dhe Shqipëri që merren me mbrotjen, shpëtimin dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës lokale mbi rrezikun e përmbytjeve.

Kuzhina lokale si ofertë turistike në rajonin ndërkufitarë

Agjencia për Zhvillim Rajonal Bjelasica, Komovi & Prokletije, bashkë me Organizatën Nacionale Turistike të Malit të Zi, Eco Partners dhe Bashkinë Pukë nga Shqipëria, përfunduan zbatimin e projektit që merrej me kuzhinën lokale si një mundësi për ofertë turistike në zonën e komunave Berane, Andrijeviçë, Plavë, Guci, Petnjicë dhe Rozhajë nga ana e Malit të Zi dhe zonën e bashkisë Pukë në Shqipëri.



Organizata AZHR BKP deklaron që "brenda këtij projekti të veçantë, gastronomia lokale është identifikuar si një aset i rëndësishëm për diversifikimin e ofertës turistike në rajonin ndërkufitar dhe që synimi i tyre është të ndërtojnë, mbi ofertën e gastronomisë, avantazhe tek burimet e tjera të iniciativave ndërkufitare".

Rezultatet e projekti janë 2000 udhëzues të dizenuar dhe printuar me 50 receta tradicionale të vjetra, 2 itinerare tematike gastronomike me sinjalistikën përkatëse, 20 familje të ndihmuara për përmirësuar kushtet për pritjen e vizitorëve dhe kushtet për të shijuar produktet e tyre, 40 familje të trajnuara për të ofruar shërbim cilësor dhe një brend dhe logo "Mountain Bounty" të krijuar për të identifikuar bizneset dhe familjet që ofrojnë ushqim tradicional.

Vizitoni këto bujtina përgjatë dy itinerarëve dhe merrni më shumë informacion tek faqet <http://www.gastro-puka.com/en> dhe <http://montegastro.me/>.




U vendosen dhe u promovuan standardet për "Turizmin miqësorë për fëmijët"

Shoqata për Demokraci dhe Prosperitet - ADP-Zid, në bashkëpunim me qendrën "Fëmijët Sot" nga Shqipëria, brenda aktiviteteve të parashikuara të projektit, çelën faqen <http://www.childfriendlytourism.com> që në fazat e para të projektit. Promovimi i faqes, bashkë me regjistrimin e ofertave të reja u realizua

gjatë 3-mujorit të fundit të vitit 2020. Standarde të reja për *Turizmin miqësorë për fëmijët* u krijuan dhe promovuan tek aktorët e interesuar.

Standardet e turizmit “Miqësorë për fëmijët” bazohen nga 4 parime themelore dhe kuptimin e drejtë të nevojave dhe aktiviteteve rutinë të fëmijëve dhe familjeve. Kjo u realizua në mënyrë që të planifikohet sa më saktë ofrimi i pajisjeve dhe lehtësirave turistike që janë pjesë përbërëse e përbushjes së nevojave gjatë përdorimit të ofertës turistike.

Të gjithë infomacionet mbi standardet e turizmit miqësorë për fëmijët mund ti gjeni [këtu](#).



Informacione mbi projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike

Projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* zbatohet nga Qendra për mbrojtjen dhe hulumtimin e zogjve, Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC), Shërbimi i shpëtimit malor të Malit të Zi dhe Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste “Pashtriku”. Në kuadër të projektit, është përgaditur edhe një video e re promovuese që promovon rajonin e ndërkufitarë.



Shikoni videon [këtu](#).

Nisma të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave

Konferenca përfundimtare e projektit *Nisma të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave* u mbajt më 26 gusht të vitit 2020. Projekti është zbatuar nga ndërmarrja e Shërbimeve komunale Plavë në Malë të Zi dhe Kompania Regjionale e Mbeturinave Çabrati – Gjakovë në Kosovë. Partnerët e projektit prezantuan rezultatet e arritura para mediave dhe një numri të kufizuar të palëve të interesuara për shkak të pandemisë COVID-19.

Shikoni videon nga konferenca [këtu](#).



Gjegjësisht, përmes projektit u krijuan parakushtet teknike për menaxhim të integruar të mbetjeve të ngurta në dy komuna. Për më tepër, janë krijuar dy kantierë riciklimi në territorin e dy komunave (Plavë, Mal i Zi dhe Gjakovë, Kosovë). Kantierët e riciklimit janë pajisur me dy transportues, dy makina shpimi për shishet PET, dy presa vertikale për dorëzimin e lëndëve të para dytësore dhe dy grumbullues paletash dore. Për më tepër, nëntë pika riciklimi u vendosën në territorin urban të komunës së Plavës dhe Gucisë në Mal të Zi dhe 10 pika riciklimi të vendosura në territorin urban të komunës së Gjakovës në Kosovë. Për më tepër, disa trajnime edukative për ndërmarrjet publike lokale dhe të tjerët kanë përfunduar.

Për më tepër, kontejnerët dhe koshat e tjerë për përdorimin nga ana e qytetarëve janë blerë dhe po përdoren në përputhje me rrethanat.



Qendrat i2 u hapën në Pejë dhe Podgoricë

Në kuadër të projektit *Vetëpunësimi dhe sipërmarrja sociale për të rinjtë* zbatuar nga Shoqata për Prosperitetet Demokratik - Zid, OJQ Lens, Qendra Liberale Demokratike dhe Qendra për Aftësi Kreative janë hapur dy iz qendra. Gjegjësisht, Hapësira për Ide dhe Inovacion "I2 space" ka hapur dyert për të rinjtë nga Peja, Istogu dhe Deçani. Deri tani, dy trajnimet e para në fushën e 3D Printimit dhe Dizajnit Grafik tashmë janë realizuar. Përveç që paten mundësinë të njihen me hapësirat e krijuara posaçërisht për ta, pjesëmarrësit kanë fituar njohuri të reja nga fushat e përmendura dhe kishin mundësinë të përdorin pajisjet e disponueshme në hapësirë për krijimet e tyre të para.



Në Podgoricë, në fund të dhjetorit të vitit 2020 u hap një thirrje për të rinjtë e interesuar për tre trajnime në temat vijuese: Programimi dhe personalizimi i faqeve të internetit, Marketingu Dixhital dhe Fotografi.



i2space obuke u Podgorici

- Programiranje i kustomizacija web stranica 
- Digitalni marketing 
- Fotografija 

Rok za prijavu: 14. decembar 

Pajisjet për feramat demo të blera dhe vendosja e fushave demo

Projekti *Punë të gjelbërta për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës* ka përfunduar me zbatimin e aktiviteteve.



Projekti u zbatua nga Komuna e Andrijevics dhe OJQ Bashkimi i Fermerëve të Veriut të Malit të Zi dhe OJQ Grupi Lokal i Veprimit Gjeravica nga Kosova. Rezultatet kryesore të projektit ishin hartëzimi i burimeve në komunat e synuara në Mal të Zi dhe Kosovë, prodhimi i manualeve për feramat fillestare, organizimi i trajnimeve edukative për 50 fermerë në Mal të Zi dhe Kosovë, krijimi i qendrës së trajnimit në Kosovë (me demo fusha dhe demo ferma) dhe organizimi i dy panaireve bujqësore (një në Mal të Zi dhe një në Kosovë). Të gjitha rezultatet u prezantuan në dy video promovuese gjatë konferencës përfundimtare që u organizua në Mal të Zi.



Për të shikuar videon promovuese për Malin e Zi klikoni [këtu](#).

Zeleni poslovi za bolju budućnost prekograničnog regiona Crne Gore i Kosova






Ovaj projekat je financiran
od strane Evropske unije



Për të shikuar videon promovuese për Kosovën klikoni [këtu](#).



Pajisje të vlefshme dhe ndërgjegjësimit në projektin CARES

Projekti CARES – Veprimet ndër-kufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues është zbatuar nga FORS Mali i Zi dhe ECMI Kosovë - Qendra Evropiane për Çështjet e Minoriteteve në Kosovë. Projekti përfshiu territorin e komunave të Andrijevices, Beranes, Bijelo Poljes, Gucisë, Petnjicësu, Plavës, Kolashinit, Mojkovacit dhe Rozhajes në Mal të Zi dhe Pejës, Istokut, Klinës, Deçanit dhe Gjakovës në Kosovë.



Qëllimi i tij kryesor ishte të përmirësonte shëndetin riprodhues të grave nga zona e programit, me theks në grupet e cenushme, duke zhvilluar cilësinë e shërbimeve të shëndetit riprodhues në zonën e programit dhe duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit riprodhues.

Aktivitetet kryesore të projektit përfshinin organizimin e më shumë se 700 ekzaminimeve parandaluese për gratë nga rajoni i synuar, prokurimin e pajisjeve të reja për qendrat shëndetësore në të dy anët e kufirit, organizimin e ligjeratave në komunitetet lokale dhe shkollat e mesme, zhvillimin dhe shpërndarjen e botimeve mbi shëndetin riprodhues, shënimin e Tetorit si muajin e ndërgjegjësimit mbi kancerin e gjirit dhe Javës së parandalimit të kancerit të qafës së mitrës, organizimin e tryezave të rumbullakëta për shëndetin riprodhues, organizimin e konferencës ndërkufitare për përmirësimin e shëndetit riprodhues, zhvillimin e fushatës mediatike, etj.

Përmes projektit, pajisjet e reja me vlerë më shumë se 130,000 euro iu dhanë qendrave shëndetësore në Mal të Zi dhe Kosovë. Pajisjet përfshijnë makina me ultratinguj, sonda me ultratinguj, instrumente mjekësore, kolposkopë, pajisje, etj. Zbatimi i këtij aktiviteti të projektit kontribuoi në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ata ofrojnë për qytetarët në rajonin e synuar.

FAKTE TE SHPEJTA – CARES

Dr Zuhra Hadroviq, Drejtoresha e Qendrës Shëndetësore në Berane, mbi projektin CARES tha: *“Prokurimi i pajisjeve mjekësore lehtësoi ndjeshëm punën e përditshme të ekipeve të përbërë nga mjekë të zgjedhur për gra. Procedurat diagnostike gjinekologjike janë bërë më të thjeshta dhe më të shpejta, gjë që rriti kënaqësinë e grave si përdoruese të këtyre shërbimeve. Pajisjet e reja i mundësojnë stafit të vendosin diagnozën me siguri më të lartë dhe kursen në mënyrë të konsiderueshme kohë, gjë që rrit efikasitetin dhe efektivitetin e punës së tyre.”*

Dr Samoni Loxha, Shef i Repartit Gjinekologjik në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë në lidhje me projektin: *“Projekti ka përmirësuar punën dhe rutinën time të përditshme, pasi puna ime në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës është lehtësuar shumë me pajisjet që kemi marrë si donacion.”*

Të Bashkuar Kundër Ndotjes

Komuna e Gjakovës në bashkëpunim me OJQ Let's Do It Peja në Kosovë dhe Komunën e Petnjicës në Mal të Zi dhe Qendrën për Zhvillim Rajonal nga Rozhaja në Mal të Zi po zbatojnë projektin *Të bashkuar kundër Ndotjes* që përfshin banorët që jetojnë pranë deponive ilegale, autoritetet komunale, punonjës në menaxhimin e mbeturinave dhe studentë nga komunat e Gjakovës dhe Petnjicës.



Një seri aktivitete janë zbatuar në tremujorin e fundit të vitit 2020. Falë investimeve të vogla në infrastrukturë brenda këtij projekti, Kompanitë e Shërbimeve Publike në Gjakovë (Kosovë) dhe Petnjicë (Mal i Zi), si përfituesit përfundimtarë, tani do të kenë një hapësirë dhe pajisje të reja për ndarjen e mbeturinave të mbledhura para se ta hidhnin në deponitë sanitare. Gjithashtu, 40 punëtorë kanë marrë rroba mbrojtëse dimërore të punës duke mbrojtur në këtë mënyrë shëndetin e tyre gjatë punës në zonën e ndotur dhe gjatë trajtimit të mbeturinave të ndotura. Për më tepër, punëtorët e përfituesëve janë trajnuar për t'u marrë me mbeturinat dhe për të mbrojtur shëndetin e tyre gjatë mbledhjes së mbeturinave.



Shikoni faqen e projektit [këtu](#).

Vazhdon sinjalizimi i itinerarit ndërkufitarë

Projekti *Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës* zbatohet nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal – Perëndimi (AZHR-Perëndim) dhe Komuna e Pejës në anën e Kosovës dhe Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije dhe Organizata turistike e Plavës nga pala malazeze.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2020, instalimi i sinjalizimit vazhdoi në terren dhe turistët që do të vizitojnë Pejën dhe Deçanin në Kosovë dhe Plavën, Gucinë, Andrijevicen, Beranen dhe Rozhajen në Mal të Zi do të kenë një ofertë të përmirësuar turistike.




Përdorni Instrumentin e Kërkimit të Partnerëve për të gjetur partnerin tuaj të ardhshëm në projekt

Jeni duke kërkuar partner për një projekt të ri në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri ose programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020? Instrumenti ynë për kërkimin e partnerëve është i disponueshëm t'ju asistojë për gjetjen e partnerëve. Ju lutemi që të plotësoni formularin e kërkimit të partnerit dhe publikoni informacionin në bazën tonë të të dhënave në mënyrë partnerët e tjerë të interesuar të kenë mundësinë të ju kontaktojnë.

Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK BNK Mal i Zi – Shqipëri 2014 - 2020.

Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK BNK Mal i Zi -Kosovë 2014-2020.

Notifikim: SPT mbetet në dispozicion të aplikuesëve potencial dhe përfituesve të granteve përmes kanaleve të krijuara të komunikimit, duke marrë parasysh që i gjithë stafi i SPT-së ka punuar vazhdimisht nga shtëpitë e tyre dhe, së fundmi, nga zyrat e tyre në mënyrë të zakonshme. Në rast se keni nevojë për ndihmë ose informacion në lidhje me programet ndërkufitare, na [kontaktoni](#).



»» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,
Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian